

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL MAMUSHË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr 1 i prokurimit	626-25-5557-5-2-1
Nr i brendshëm	626-25-007-5-2-1

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Bajram Ha. Gashi B.I. _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com _____
(Adresa)

Suhareke _____
(Vendi) (Kodi postar)

049/356164 _____
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Bajram Gashi _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com _____
(Adresa elektronike)

26.08.2025 _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

ëShëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">- B05 Njoftim per Kontrat 23.06.2025- B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 15.07.2025- Hapja e ofertave 24.07.2025- B58- Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues- 21.08.2025 |
|---|

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

- | |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">- Hapja e ofertave 24.07.2025 |
|---|

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar konsoliduar

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11- Informatat Sekret Afarist
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 61 Tenderët Jo normalisht të ulët
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrevshjeve,

Rregullorja me nr 001/2022, për Prokurim Publik konsoliduar

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 41 Tenderët jo normalisht të ulët
Neni 97 Shkeljet e rënda

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar,

OE Bajram Ha Gashi B.I., si palë interesi në këtë proces të prokurimit, kërkojmë që të rishqyrtohet vendimi i AK- Komuna Mamushë i datës 21.08.2025 dhënë përmes formës B58- Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, pasi që një vendim i tillë është në kundërshtim me parimet e garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë. Rrjedhimisht ne nuk pajtohemi me vendimin tuaj në fjalë dhe parashtrojmë pretendimet tona ankimore si vijon:

Pretendimi ankimore 1.

Bazuar në kërkesën tonë të datës 21.08.2025, për qasje në dokumentacion në këtë procedurë prokurimi, AK më 22.08.2025 na ka ofruar qasje të kufizuar: anekset, marrëveshja mbi konsorciumin, certifikata e biznesit, dokumentet ATK, lista e stafit, kerkese per dokumente shitesë nga AK, raporti i vlerësimit të tenderit, vlerësimi i riskut, lista e pajisjeve, vendimi per menaxherin e projektit, sigurimi i tenderit, B47 dhe B41, dokument nga DT, cert.denimet penale dhe nga gjykata, lista e projekteve, pergjigje e OE ndaj B47, paramasa dhe parallogaria, sigurimi i tenderti, pergjigje e OE ndaj B41 dhe vërtetimi tatimor. Pjesa tjetër e dokumenteve nuk është shpalosur, bazuar në kërkesën e OE përkatëse për sekret afarist. Ky mohim i qasjes përfshin dokumentacionin që lidhet me:

- Gjendjen ekonomike dhe financiare (pika 8.1 & 8.2 e DT-së – kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe dëshmitë përkatëse),
- Kapaciteti teknik e profesional pika 9.1&9.2 e DT

Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar versionin e pastruar ashtu siç do duhej të vepronte në këto raste, pasi që është kërkesë e domosdoshme sipas LPP kur në procedurën e prokurimit publik ekzistojnë dokumente të klasifikuara si “sekret afarist”. AK nuk ka përmbushur obligimin ligjor për përgatitjen dhe ofrimin e versionit të pastruar sipas kërkesave të LPP dhe rregullores përkatëse.

Në këtë rast AK nuk ka vepruar në harmoni me nenet:

Neni 7.6.2. Zyrtari përgjegjës i prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me nenin 11.4 dhe të njoftojë palën. (Rregullore nr 001/2022 për prokurimin publik-versioni i konsoliduar).

Neni 7.6.3. Zyrtari i prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE, sipas nenit 4.1.26 pas publikimi të vendimit të AK (B58) ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal.

Është përgjegjësi e AK që të sigurojë se pjesët e deklaruara si sekret afarist të mbrohen nga shpalosja e paautorizuar, **por është i detyruar të përgatisë versionin e pastruar** të dokumenteve në përputhje me LPP dhe rregulloren 001/2022 duke siguruar mbrojtjen e informacionit dhe repsektimin e të drejtave të të gjitha palëve të interesit në aktivitetin e prokurimit publik.

Rrjedhimisht me këtë veprim të AK na është kufizuar edhe mundësia për të mbrojtur dhe kërkuar të drejtën tonë legjitime, garantuar me LPP dhe ligjet tjera në fuqi.

Mohimi i tillë i qasjes në dokumentacion publik është shkelje esenciale e ligjit për prokurim publik, nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligje tjere që rregullojnë fushën e prokurimit publik në Kosovë (të cilëve u referohemi në këtë tekst me shkurtesën e njohur LPP).

Konkretisht, neni 10 dhe 11, i LPP-së, përkatësisht nenit 7, i Rregullores për Prokurim Publik, trajton çështjen e dokumentacionit që përmban informata sekret- afarist.

Duke qenë se kompania jonë është palë me interes në këtë procedurë prokurimi, disponon interes juridik i përcaktuar me nenin 4.1.26 të LPP-së .

Në anën tjetër, lidhur me kërkesën e OE për klasifikimin e dokumentacionit si sekret afarist në një procedurë prokurimi publik, paragrafi 4 i nenit 11, të LPP-së përcakton se:

“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informata sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste”.

Edhe pse e kemi të qartë se AK ka klasifikuar si sekret afarit dokumentet sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë, fakti se nuk na është vënë në dispozicion asnjë version i pastruar i tyre përbën shkelje të dispozitave ligjore të akteve ligjore të përmendura më sipër e për rrjedhojë neve si palë interesi në këtë procedurë na është mohuar e drejta në qasje në dokumente dhe informata publike.

Pretendimi ankimor 2

GOE e propozuar për kontratë në bazë të vendimit përmes formës B58 të datës 21.08.2025, nuk është e përgjegjshme sepse nuk përmbush kërkesat e DT lidhur me listën e kërkuar të pajisjeve, të specifikuara nga Aneksi 8 i DT. GOE nuk plotëson kërkesën për kamion me korp me mekanizëm për bartje dhe ngritje të shportës. Pajisja e tyre nuk i plotëson të gjitha kërkesat e specifikuara nga DT. Andaj AK duhet të shqyrtojë edhe këtë kërkesë të DT dhe të rishqyrtojë vendimin e tyre të datës 21.08.2025.

Pretendimi ankimor 3

Bazuar në analizën e nxjerrë nga AK- Komuna Mamushë dhënë përmes formës B41 Leter Standarde e kërkeses per informata mbi tenderët jo normalisht të ulët, të datës 07.08.2025, OE e shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulta pasi që oferta e tyre ka plotësuar të tri kushtet e paracaktuara nga LPP neni 61 përkatësisht Rregullore 001-2022, neni 41.3.

Shkëpusim në vijim vlerësimin e dhënë nga AK për ofertën e OE së rekomanduar për kontratë.

Andaj, kërkojmë që të na dërgoni informatat në lidhje me pozicionet e më poshtme të cilat i kemi ndarë në çmime jo normalisht të ulëta dhe në çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Çmimet jo normalisht të ulëta:

Pjesa A. Pozicionet: 14, 16 dhe 17.

Pjesa B. Pozicionet: 3, 8, 14, 15, 16, 17 dhe 19.

Pjesa C. Pozicionet: 4, 5, 6, 7, 8, 9, dhe 10

Pjesa D. Pozicionet: 5, 6, 7, 10, 12, 13, 14, 28, 31, 32, 33, 34, 36, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 52, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, dhe 63.

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A. Pozicionet: 1 .

Pjesa B. Pozicioni: 3 dhe 18.

Pjesa D. Pozicionet: 47, 48, 49, 50 dhe 51.

OE në përgjigjen e tyre dhënë ndaj kërkesës për sqarim sipas formës B41, kërkojnë që vlerësimi i ofertës së tyre të bëhet si tërësi, kurse lloji i kontratës në këtë aktivitet të prokurimit është Kontratë kornizë e vlerësuar me çmimin për njësi. Shkëpusim si shembull, pozicionin 3 nga pjesa B, i cili duhet t'ju kishte tërhequr vëmendjen më tepër juve si AK pasi që është rreth 10 fish më i shtrenjtë se çmimi i tregut apo pozicioni tjetër 8 te pjesa B i cili është më tepër se 10fish më i ulët se çmimi i tregut! Nëse këto luhatje dhe mosstabilitet i çmimit nuk janë shqetësuese për ju, atëherë vlerësimi juaj si AK në këtë aktivitet të prokurimit është joprofesional dhe diskriminues dhe i dëmshëm për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe parane publike.

Në vijim, shkëpusim arsyetimin sipërfaqësor dhënë nga OE në fjalë, ndërsa për faturat që u referohen si dëshmi, janë një sërë faturash të grumbulluara nga e kaluara të cilat edhe janë konsumuar në aktivitete të tjera dhe për këtë aktivitet nuk përbëjnë relevancë:

Poashtu ne kërkojmë që **oferta jone te vleresohet si teresi** pasi qe ne kemi ofertuar si oferte ne totale e jo vetem per keto pozicione, pra pozicioni qe eshte me 1 lire mund te mbulohet edhe nga pozicionet tjera qe ne rastin konkret pozicionet per te cilin ju keni kerkuar sqarime shtese njeri mund te mbulohet me pozicionet tjera dhe oferta duhet te merret si oferte totale.

Me posht gjeni faturat dhe deshmitë e tyre



Tutje, Vendimi i Autoritetit Kontraktues për pranimin e përgjigjes së Operatorit Ekonomik lidhur me ofertën e tij jonormalisht të ulët dhe tepër të lartë, si dhe për ta konsideruar të vlefshme ofertën vetëm mbi bazën e rritjes së sigurimit të ekzekutimit nga 9,000 € në 27,000 €, është i kundërligjshëm dhe i pambështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik. Ky vendim bie ndesh me nenin 61 të LPP-së, i cili qartë obligon që ofertat **jonormalisht të ulëta**

të justifikohen me analiza të kostove dhe me prova konkrete për secilin pozicion të kontestuar, dhe në mungesë të këtyre, oferta duhet të refuzohet. Në rastin konkret, përgjigja e OE nuk përmban arsyetime substanciale, por vetëm dokumentacion formal dhe fatura të së kaluarës, të cilat logjikisht edhe janë të konsumuara në punët tjera, të përgjithshme dhe të palidhura me pozicionet e paramasës, ndërsa arsyetimet e dhëna janë të natyrës së përgjithshme dhe të përsëritura (“fugia punëtore, përvoja, stoqet”), pa ndarje të qartë të kostove apo shpjegim ekonomik për çmimet jonormalisht të ulëta dhe ato jonormalisht të larta. Për më tepër, AK ka zëvendësuar detyrimin ligjor për të bërë vlerësim kritik të ofertës me një masë financiare të rritur të sigurimit të ekzekutimit, çka nuk është e paraparë në LPP dhe nuk garanton mbrojtje reale të buxhetit publik madje hap rrugën për keqpërdorim e manipulim. Ky veprim përbën shkellje të parimit të barazisë dhe konkurrencës së ndershme, promovuar nga LPP dhe tregon qartë se kemi të bëjmë me një vendim të pambështetur ligjorisht. Indikatorë alarmues, që dalin nga ky rast janë:

- çmimet e ofertës nuk përputhen me tregun dhe paraqesin elemente të qarta të “jostabilitetit të çmimit” (disa çmime jonormalisht të ulëta për të fituar tenderin dhe disa të fryra për të kompensuar fitimin),
- dokumentacioni i paraqitur gjoja si dëshmi është vetëm formal, me fatura të së kaluarës që nuk mbulojnë pozicionet e paramasës,
- mungesa e analizës ekonomike të detajuar e bën përgjigjen pro forma dhe jo substanciale, dhe
- pranimi i një oferte të tillë vetëm mbi bazën e rritjes së sigurimit krijon trajtim preferencial dhe ekspozon kontratën ndaj rrezikut serioz të moszbatimit dhe buxhetin publik ndaj dëmit potencial.

Për më tepër, vetë dokumenti i përgjigjes së OE nuk përmban datë të lëshimit, duke pamundësuar verifikimin e respektimit të afatit 5-ditor të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, çka paraqet mangësi serioze formale dhe e bën përgjigjen të pasigurt nga aspekti juridik dhe proceduror. Lidhur me çështjen e çmimeve jonormalisht të ulëta dhe tepër të larta që e kanë karakterizuar ofertën e GOE të shpërblyer me kontratë- bazuar në vlerësimin e bërë nga AK përmes formës B47 të datës 07.08.2025, Autoriteti kontraktues, nuk i drejtohet personit të autorizuar të grupit, por anëtarit për të marrë përgjigjen. Si duket, ju si autoritet kontraktues keni pranuar çdo lloj përgjigjeje vetëm sa për të plotësuar hapat proceduralë në mënyrë formale duke mos u shqetësuar për përmbajtjen e përgjigjeve të pranuar apo ofertën me indikatorë alarmues të çmimeve jashtë vlerës së tregut (tejet të larta apo tejet të ulëta). Oferta e tillë ka elemente të dukshme të çmimeve të pabalancuara, për shkak se disa pozicione janë ofruar me çmime jonormalisht të ulëta për të krijuar avantazh në fitimin e tenderit, ndërsa disa të tjera janë ofruar me çmime jonormalisht të larta me qëllim kompensimi financiar. Një praktikë e tillë bie ndesh me parimet e nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik, ngase cenon konkurrencën e ndershme dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për të gjitha këto arsye, vendimi i AK duhet të anulohet dhe oferta e OE duhet të shpallet e papranueshme, ndërsa procesi të vazhdojë në pajtim me LPP, duke e rekomanduar kompaninë tonë si OE e përgjegjshme në pajtim me të gjitha kërkesat e DT, përfshirë dhe çmimin.

Prandaj para ndermarrjes se veprimeve tjera ligjore ne instanca tjera dhe jo vetëm ne OSHP, ne si OE ankues kërkojmë që AK-Komuna Mamushë të nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **Të aprovohet** në tërësi kërkesa jonë për rishqyrtim, si e bazuar
- II. **Të anulohet njoftimi** – vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivleresim
- III. **Të rekomandojë kompaninë tonë për dhënie kontrate**, pasi që plotësojmë kushtet e parapara në këtë procedurë prokurimi, jemi i vetmi ofertues i përgjegjshëm në këtë procedurë prokurimi që plotëson të gjitha kriteret e parapara me DT.

Në rast të vazhdimit të moszbatimit të dispozitave ligjore dhe shmangies së përgjegjësisë për vlerësimin e duhur, ne si kompani do të detyrohemi të raportojmë edhe në instanca të tjera, duke mos u kufizuar vetëm në OSHP, dhe do të kërkojmë veprime ligjore për shkelje të përseritur të dispozitave thelbësore dhe parimeve bazë mbi të cilat duhet të bazohet aktiviteti i prokurimit publik në Kosovë. Ne si kompani ndihemi thellësisht të diskriminuar nga vlerësimet e kryera nga AK Komuna Mamushë. Me këtë gjykim të cekët ju po krijoni pasiguri juridike, tentohet të abuzohet me ligjin dhe paratë publike. Andaj kërkojmë nga ju që këto veprime të dëmshme të ndërpriten dhe lënda të rivlerësohet, duke konsideruar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ne.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet janë të shumëfishta, në aspekt moral dhe material, të cilat në procedura eventuale tjera do t'i kalkulojmë dhe do të kërkojmë që të na kompensohen.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.